



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT SHKODER



358/1  
Nr. prot.


Shkodër, më 07.05.2026

**Lënda:** Mbi Vendimin Nr. 28, datë 29.04.2026 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës.

**KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS**

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 “Për Prefektin e Qarkut” i përditësuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, të ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” i përditësuar, u njoh me Vendimin Nr. 28, datë 29.04.2026 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës për program strehimi referuar ligjit nr.22/2018, subvencion qeraje për B.F, akt me karakter njohës, me karakter jo normativ, për të cilat Prefekti referuar ligjit Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, nuk ka detyrim të shprehet.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,



**PREFEKTI**

**Holta DUDA**



**BASHKIA VAU DEJËS  
KËSHILLI BASHKIAK**

**VENDIM**

Nr 28 Datë 29/04/2026

**“Për miratimin e së subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për z.Bujar Ferizolli në programin e strehimit “Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë”**

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar; nenit 38 i Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”i ndryshuar;VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;VKM-së nr.362 prot,datë 29.05.2019 “Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKB-së nr.48, datë 26.07.2021 “Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026” në Bashkinë Vau Dejës; VKB-së nr.40, datë 28.06.2021 “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit “Subvencion i qirasë në tregun e lirë”; VKB Nr. 57 me 27.10.2025 “Për miratimin e ndyshimit të VKB Nr.21 datë 26.03.2025 dhe VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit ” VKB-së nr. 47, datë 26.06.2024 “Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë , për familjet qe perfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave”. Proceverbali i mbajtur nga Komisioni i Strehimit me datë 16.02.2026,Këshilli Bashkiak:

**VENDOSI**

- 1.Miratimin e së subvencionit të qirasë dhe vlerën e përfitimit për z. Bujar Ferizolli në programin“Subvencion i qirasë në tregun e lirë” sipas tabelës dhe pjesës përbërëse të këtij vendimi.
- 2.Subvencioni i qirasë do t’i jepet përfituesit që nga momenti i miratimit të listes së përfituesve me vendim të këshillit të vetëqeverisjes vendore , ( pika 4 neni 39, ligji 22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar .



SEKRETARATI I VAU I DEJËS

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet "Drejtoria e Mbrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social ,  
Sektori i Strehimit Social"

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të  
Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore" i ndryshuar.

**KRYETARI I KËSHILLIT**  
**Ervis SHIMAJ**



**SEKRETARI I KËSHILLIT**  
**Ardian CELEPIJA**

Miratuar me 19 .....vota  
Vota pro 19  
Vota kunder .....  
Vota Abstenim .....  
Zbardhur me datë 05.05.2026



Programi: Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë.

Vlera maksimale e subvencionimit të qirasë në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave dhe të ardhurave të familjes

| Nr Rendor   | Emër  | Mbiemër  | Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr.22/2018                                       | Përberja e Banesës (Shtëpi Familjare Private) | Struktura e Banesës (Shtëpi Private) | Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionimit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave VKB nr. 47; datë 26.06.2024 | Qiraja reale | Të ardhurat Familjare mujore (neto) | Aftësia përballues e (%) | Qiraja e përballua shme | Subvencioni në muaj që mbulohet nga bashkia në Lek | Shuma që kërkohet nga bashkëti në shtetit në Lek | Subvencioni në vit në Lek |           |
|-------------|-------|----------|--|---|--------------------------------------|---|--------------|-------------------------------------|--------------------------|-------------------------|--|--|---------------------------|-----------|
| 1           | Bujar | Fenzolli | Familje pa të ardhura sipas nenit 2, pika 45 e ligjit 22/2018 "Për Shtetimin Social" | 4   | 2+1                                  | 21,000  | 15,000       | -                                   | 0.00                     | 0                       | 15,000.0   | 0  | 180,000.0                 |           |
| Totali muaj |       |          |  |   |                                      |   |              |                                     |                          |                         |  | 15,000.0   | 0                         | 180,000.0 |

Shtetimi; Subvencionimi i qirasë fillon që nga momenti i miratimit të vlerës me vendim të keshillit të njetisë së vetëqeverisjes vendore- deri në ndryshimin e kushteve social ekonomike të banorit.



KRYETAR  
Ervis Shimaj

Sekretari Keshillit Bashkëti  
Ardian ÇELEPIJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL  
SEKTORII STREHIMIT SOCIAL

PROJEKTVENDIM

Nr. 04 datë 18.03 2026

**“Për vazhdimësinë dhe vlerën e përfitimit për z. Bujar Ferizolli në programin e strehimit “Subvencioni i qirasë në tregun e lirë”**

Në mbështetje të nenit 24 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 “ Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar: nenit38 i Ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social”i ndryshuar; VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”;VKM-së nr.362 prot,datë 29.05.2019 “Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxheut të shtetit, dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKB-së nr.48, datë 26.07.2021 “Për miratimin e Plani të Strehimit Social 2021-2026” në Bashkinë Vau Dejës; VKB-së nr 40, datë 28.06.2021 “Për miratimin e procedurave për zbatimin e programit social të strehimit: “Subvencion i qirasë në tregun e lirë”; VKB Nr. 57 me 27.10.2025 “Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr.21 datë 26.03.2025 dhe VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit”Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave”. Proces-Verbali i mbajtur nga Komisioni i Strehimit me datë 12.03.2026.

## VENDOSI

1. Miratimin e vazhdimesisë dhe vlerën e përfitimit për z. Bujar Ferizolli në programin "Subvencioni i qirasë në tregun e lirë", sipas tabelës dhe pjesës përbërëse të këtij vendimi.
2. Subvencioni i qirasë do t'i jepet përfituesit që nga momenti i miratimit të vlerës me vendim të këshillit të vetëqeverisjes vendore, ( pika 4 neni 39, ligji 22/2018 "Për Strehimin Social" i ndryshuar .
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet "Drejtoria e Mbrojtjes Përfshirjes dhe Strehimit Social, Sektori i Strehimit Social"

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore").

**KRYETAR**  
Kristian Shkreli

Në mungesë dhe me urdhër  
ZV/KRYETARI  
Aleksandra Gjoni



Konceptoi: E.Gjecaj  
Pranoi: D.Lleshi  
Miratoi: R.Luzaku  
Konfirmoi Bazen Ligjore: E.Preka



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJËS

DREJTORIA E MBROJTJES PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL  
SEKTORI I STREHIMIT SOCIAL

Nr.      prot.

Vau Dejës, më 18.03, 2026

RELACION

**“Për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit për z. Bujar Ferizolli në programin e strehimit “Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë”**

Të nderuar këshilltarë!

Në zbatim të ligjit nr.22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar, Bashkia Vau Dejës po zbaton disa nga programet e strehimit social, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

Subvencioni i qirasë si një instrument i programit të banesave sociale me qira, mbështet individë/familje që me të ardhura e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë.

Subvencioni i qirasë realizohet nga bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg.

Për këtë instrument në zbatim të programit të strehimit “Subvencion i qirasë, në tregun e lirë” është ndjekur procedura , sipas VKM-së nr.384 prot, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo program social të strehimit dhe të afateve dhe procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”,

Komisioni i Strehimit i ngritur me VKB Nr. 57 me 27.10.2025 “Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr.21 datë 26.03.2025 dhe VKB Nr.33 datë 28.04.2023 dhe VKB Nr.80 datë 30.10.2023 për ngritjen e Komisionit të Strehimit

Me datë 12.03.2026 u bë shqyrtimi i dokumentacionit të plotë i rinovuar dhe kontratës së qirasë noteriale për banorin Z. Bujar Ferizolli nga komisioni i strehimit.

Familja trajtohet me ndihmë ekonomike dhe nuk ka të ardhura të tjera, gjë që e bën të vështirë, që kjo familje të paguajë qiranë.

Duke shikuar këto probleme sociale-ekonomike dhe duke shqyrtuar me përpikmeri dosjen dhe kontratën e qirase noteriale, komisioni e shikoj të arsyeshme që dosja e banorit Z. Bujar Ferizolli, të kualifikohet si e rregullt.

Për llogaritjen e vlerës së subvencionit të qirasë Komisioni i Strehimit u bazua në VKM-në nr.362 prot, datë 20.05.2019 “Për Kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit, dhe

mënyrën e llogaritjes së tij”, dhe realizohet nëvarësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës maksimale të qirasë në treg të lirë të miratuar me VKB nr. 47, datë 26.06.2024 “Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për vitin 2024, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirasë në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave”. Vlerat konkrete të subvencionit të qirasë për çdo përfitues përcaktohen sipas kontratave të qirasë të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas Shtojcës “A” të VKM-së nr.362, datë 20.05.2019.

Lista e dhe vlera e subvencionit të qirasë janë të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur projekt-vendimit nga ku është detajuar edhe efekti financiar që rrjedh për zbatimin e këtij programi që do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Vau Dejës.

Në këto kushte për realizimin e këtij programi të strehimit social duhet të miratohet në këshill bashkiak projekt vendimi i propozuar “Për miratimin e vazhdimësisë dhe vlerën e përfitimit Ne programi e strehimit “Subvencioni i qirasë në tregun e lirë”  
**Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!**

Konceptoi: E.Gjecaj





**BASHKIA VAU DEJËS**  
**Komisioni i Strehimit**

Nr. 1814 Prot.

Vau Dejës më 18 .03 . 2026

**Proces -Verbal**

**“Subvencioni i qirasë, në tregun e lirë”**

Proces verbal i mbajtur sot me datë 12.03.2026 ora 10:00, nga Komisioni i Strehimit për shqyrtimin e dokumentacionit të rinovuar, kërkues për programin e Strehimit Social “Subvencioni i qirasë në tregun e lirë”.

Paraprkishtë është bërë aktkonstatimi në banesë nga grupi i punës me Nr. 54, datë 06.02.2026 “Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e adresës së paraqitur në kontratën e qirasë noteriale”.

Mbështetur në Ligjin 22/2018 “Për strehim social” (i ndryshuar), VKM Nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas çdo programi social të strehimit dhe afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; “VKB Nr 57 dt. 27.10.2025”, “Për miratimin e ndryshimit të VKB Nr. 21 dt. 26.03.2025”, VKB Nr. 33 datë 28.04.2023 VKB 30.10.2023 “Për ngritjen e komisionit të strehimit”.

Komisioni shqyrtoi dosjet për rinovim, për përfitim në programin e strehimit “Subvencioni i qirasë në tregun e lirë”, për banorët: Bujar Ferizolli, Pjeter Zefi.

Komisioni pas shqyrtimit të dosjeve vendosi:

- Kualifikimin e dosjes së Z. Bujar Ferizolli si aplikues me dokumentacion të rregullt për të përfituar nga programi “Subvencioni i qirasë në tregun e lirë”.
- Shtyrjen e afateve për sqarim dokumentacioni tek ASHK për dosjen e Z. Pjeter Zefi.

**Komisioni i Strehimit përbërë nga:**

1. Dajana Lleshi - Kryetar
2. Silvana Ismajlaj - Zv/Kryetar
3. Marian Marku – Anëtar
4. Indrit Kurtabegu- Anëtar
5. Marketa Lleshaj – Anëtar
6. Suela Domnori- Anëtar
7. Kujtimi Nurja - Anëtar

**Të pranishëm:**

1. Dajana Lleshi -
2. Silvana Ismajlaj -
3. Indrit Kurtabegu -
4. Marketa Lleshaj -



Programi Subvencionimi i Qirave në Tregun e Lirë

Vlera maksimale e subvencionit të qirave në tregun e lirë, për familjet që përfitojnë subvencionin e qirave në tregun e lirë sipas strukturave të kësaj lloji të banesave dhe të ardhurave të familjes

| Nr. Rregullor | Emër  | Mbështetja | Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr.22/2018  | Përderjta Familjare | Struktura e Banesës (Shërbim privat) | Vendim për miratimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirave në tregun e lirë për familjet që përfitojnë subvencionin e qirave në tregun e lirë, sipas strukturave përkatëse të banesave VKB nr. 47, datë 26.06.2024 | Qiraja reale | Të ardhurat Familjare mujore (neto) | ADRSIA përballës (%) | Qiraja e shërbimit përballës | Subvencio që mund të miratohet nga bashkia në Lek | Subvencio Shuma që mund të miratohet nga buxheti i shtetit në Lek | Subvencioni në shtet në Lek |
|---------------|-------|------------|---|---------------------|--------------------------------------|---|--------------|-------------------------------------|----------------------|------------------------------|---|---|-----------------------------|
| 1             | Bajri | Ferizoli   | Familjeja të ardhura sipas nenit 1, pikë 45 e ligjit nr.22/2018 "Për Subvencionin Social" | 4                   | 0,1                                  | 21.000  | 15.000       | -                                   | 0,00                 | 0                            | 15.000,0  | 0   | 180.000,0                   |
|               |       |            |   |                     |                                      |   |              |                                     |                      |                              | 15.000,0  | 0   | 180.000,0                   |

Shtesa 1 Subvencionit i qirave fillo të miratimit të vlerës në vendim të kësaj lloji të banesave të veçueshëm vendore, deri në ndryshimin e kushteve social ekonomike të banorit.

Komisioni i Shtetit

1. Dajana Ueshi Kryesore

5. Marketa Ueshaj - Anëtar

2. Silvana Ismailaj Zg/Kryesore

Suela Domnori - Anëtar

Mirjam Marku - Anëtar

Kujtime Nuja - Anëtar

Indrit Kurtabegu - Anëtar

**DEKLARATË PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR LEJEN PËR MARRJEN E DOKUMENTACIONIT  
PËR FAZËN E DYTË TË APLIKIMIT**

**DEKLARATË**


PËRDHËNIEN E PËLQIMIT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE, AKSESIN PËR NJOHJEN DHE  
ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Unë Bujar Ferizolli biri i/e bija e Isuf Ferizolli dhe i/e lindur  
më 02.03.1978 në Tropojë, dhe banues/banuese në Kosmaj, me  
shtetësi Shiptare, me numër identifikimi H80302089 me vullnetin tim të lirë,

**DEKLAROJ SE:**

Mbështetur dhe në zbatim të:

- Fikës 16, të vendimit nr. 384, datë 12.06.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të Shërbimit Social, dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore";
- pikës 3, të nenit 14, të ligjit nr. 22/2018, "Për strehimin social" i ndryshuar;
- të neneve 2, 5 e 10, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, "Për mbrojtjen e të dhënave personale".

| Deklarimi  | Firma<br>(në latinë që aplikanti dëshiron të përdorë)                                 |
|--|---|
| <p>- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës 16, të vendimit nr. , datë , të Këshillit të Ministrave.</p> <p>- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.</p> <p>- Jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura në referim të pikës 16, të vendimit nr. <u>384</u> datë <u>12.06.2019</u>, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesës sime për të përfituar strehim sipas programeve social të Shërbimit Social të parashikuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social."</p> |  |
| <p>-Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës 16, të vendimit nr. , datë , të Këshillit të Ministrave;</p> <p>-Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.</p> <p>- Nuk jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura, në referim të pikës 16, të vendimit nr. , datë , të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për trajtimin e kërkesës sime për të përfituar strehim sipas programeve sociale të Shërbimit Social të parashikuar në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social".</p>               |   |

Bujar Ferizolli, më 03.02.2026

DEKLARUESI

Bujar Ferizolli

ANEKSI I

Format Tip i Aktit të Verifikimit në Banesë

AKT – KONSTATIMI

Sot më datë 16/02 2026, grupi i verifikimit të banesave ku jetojnë qytetarë të cilët kanë

aplikuar për të qenë përfitues të bonusit të strehimit në bazë të ligjit nr. 22/2018 "Për strehimin social" pasi verifikoi gjendjen faktike konstatoi se:

Qytetari Zelfije Ferizolli banues në adresë Kosmaj

Banon

Nuk banon

Në adresën e specifikuar në kontratën e qirasë me nr. 124, datë 16/01/2025  
81

Disponon




Nuk disponon

Shënim: Familja e Bijar Ferizollit u gjend në banesë'

Përfituesi

Bonusit: Z/Znj. Zelfije Ferizolli 18

Znj. Anëtar komisioni Nënshkrimi Dajana Heshi 11

Znj. Anëtar Komisioni Nënshkrimi Greta Mustija   
Z. Anëtar Komisioni Nënshkrimi Klariša Bistvo   
Znj. Anëtar Komisioni Nënshkrimi Abel Xhej   
Z. Anëtar Komisioni Nënshkrimi \_\_\_\_\_

Ky Akt-Konstatimi u përpilua në 2(dy) kopje, një kopje i jepet qytetarit dhe një kopje mbahet nga Sektori i Shërbimit Social.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE  
SHËRBIMI SOCIAL SHTETËROR**

VËRTETIM PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS EKONOMIKE

Bazuar në VKM nr. 597, datë 4.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, Z/Znj. Bujar Ferizolli me NID: H80302089B jeni përfitues i ndihmës ekonomike si anëtar i familjes/individ në nevojë në muajin janar.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ZYRA VENDORE E SHKODRES  
VËRTETIM

“PËR LËSHIM VËRTETIMESH (NEGATIV/POZITIV)”

Z/Znj. Zelfije Mehmet Ferizolli

Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSCAD), rezulton se në emër të shtetasit:

Z/Znj. Zelfije Mehmet Ferizolli

Nuk ka pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme.

Lëshohet sipas kërkesës nr. 2706, datë 03/02/2026.

DREJTORI  
Eglantina Frroku



Vuloëur elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Shkodër  
Data: 2025/02/03 15:30:01 +02'00'  
1354-19231/202602031329637218A/014



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

ZYRA VENDORE E SHKODRËS  
VËRTETIM

“PËR LËSHIM VËRTETIMESH (NEGATIV/POZITIV)”

Z/Znj. Bujar Isufi Ferizolli

Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme (ALBSCAD), rezulton se në emër të shtetasit:

Z/Znj. Bujar Isufi Ferizolli

Nuk ka pasuri të regjistruara në regjistrin elektronik të pasurive të paluajtshme.

Lëshohet sipas kërkesës nr. 2677, datë 03/02/2026

DREJTORI  
Eglantina Frroku



Vlerësuar elektronikisht nga Drejtoria  
Vendore Shkodër  
Data 2026/02/03 13:33:51 -02'00"  
4803020899202612031530441318401



A2025040390008669016

Shënim U aplikua pulle takse ne kopjen e arkives se noterise

**KONTRATË QIRAJE****pasueri e paluajtshme**

Sot, më datë 16 Janar 2025, para meje Notere FLLADINA F. KASTRATI, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore SHKODËR, me zyrë në adresën Shkoder, Rruga "Don Bosco", Ndertesa "Pysqyli", Bashkia Shkoder,, u paraqit personalisht:

**QIRADHËNËS:**

Hane Ferizolli, atësia Muharrem, amësia Shkurtë, shtetase Shqiptare, lindur në Shikaj, Kukës dhe banues në VAU-DEJËS, me adresë Sarac 03380190; Nd. 10; H. 1; Bushat; Kosmaç; 4021; Vau-Dejës, lindur më 20/02/1948, gjendja civile "e martuar", madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 035579667 dhe nr. personal E85220169S, .

(këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate do të quhet **Qiradhënës**).

**QIRAMARRËS:**

Bujar Ferizolli, atësia Isufi, amësia Hane, shtetas Shqiptar, lindur në Llugaj, Tropojë dhe banues në VAU-DEJËS, me adresë Lapidarit 03380112; Nd. 6; H. 1; Bushat; Kosmaç; 4021; Vau-Dejës, lindur më 02/03/1978, gjendja civile "i martuar", madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 035447335 dhe nr. personal H80302089B, . (këtu e më poshtë, për efekt të kësaj kontrate do të quhet **Qiramarrës**).

Paiët kontraktuesë me marrëveshje midis tyre, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, deklarojnë se kanë rënë dakord që në bazë të besimit reciprok, kushteve aktuale të tregut dhe legjislacionit civil Shqiptar; e përkatësisht të neneve 801 e vijues të Kodit Civil; të lidhin këtë Kontratë Qiraje (këtej e tutje, "**Kontrata**") dhe kërkuan nga unë Noterja hartimin e saj, në përputhje me ligjin, si më poshtë vijon:

**PËRSHKRIMI I OBJEKTIT**

Objekt i kësaj kontrate qiraje është dhënia me qira e një pjese te pasurise së paluajtshme – lloji pemtore + truall + ndertese, me adresë në Rrethi: SHKODËR, Qyteti/Fshati: KOSMAÇ, Shkalla: 0, , ndodhur në ZK 2236, nr. pasurie 102/137, vol. 3 fq. 136, me sipërfaqe totale 300 m2 (treqind ) m2, nga kjo sa truall 200 m2, sa ndërtesa 110 m2. Pasuria e paluajtshme është e përbërë nga një ndërtesë 1 kate.

**Nga e gjithë sipërfaqja e pasurise jepet me qera vetem ndertesa me sip 110 m2**

**Baza Ligjore:**Neni 801 e vijues të Kodit Civil,Neni 62, pika 1, gërma "ll", si dhe nenet 99, 100, 101 e vijues të Ligjit nr. 110/2018, datë 20.12.2018 "Për Noterinë".

**AFATI**

**Afati kohor** i zgjatjes së kësaj mardhënie kontraktuale qeraje do të jetë për një periudhë **3-vjeçare**, mardhënie e cila sipas kontratës nis me nenshkrimin e kontrates.

**TE DREJTAT DHE DETYRIMET**

Palët kanë rënë dakord që për efektet fiskale qeraja, do të paguhet në këtë mënyrë :

1. Qeraja mujore e objektit, pra detyrimi i Qiramarrësit ndaj Qiradhënesit do te jete e barabarte me 15.000 ne muaj (njqind e pesedhjete)
2. Pagesa e Qerese do te kryhet me date 1 te cdo muaji, duke likujduar qerane mujore paraprakisht.
3. Qiramarrësi do te paguaje faturen e dritave si dhe faturen e ujit pas paisjes me librezat perkatese dhe ne momentin e marrjes ne dorezim te objektit.



A2025040390008669016

4. Tatimin mbi te ardhurat 15 % do te paguhet nga Qiramarrësi.

Për të gjithë këtë periudhë pala QERAMARRËSE është e detyruar që :

- Të ruaj dhe të mirëmbajë objektin.
- Të mos bëjë ndryshime në strukturën e objektit pa marrë më parë pëlqimin e QERADHËNËSIT.
- Të likujdojë me korrektesi dhe brenda afateve të përcaktuara vlerën e qerasë.
- Të likujdojë me korrektesi dhe në afatin e caktuar faturat e energjisë elektrike, ujit, etj.
- Kjo kontrate qeraje hartohet me te drejte ripërteritjet në fund të afatit të caktuar, sipas kushteve dhe shumës që palët vete do të bien dakord ne momentin e ripërtëritjes së saj.
- Në përfundim të afatit të kontratës, qeramarrësi është I detyruar të dorëzojnë objektin në gjendjen e punes.

Kjo kontrate qeraje bazohet në dispozitat ligjore të përcaktuara në Kodin civil, konkretisht neni 801 e vijues. Në qoftë se ndonjëra nga palët do të tërhiqet nga kontrata para përfundimit të afatit të përcaktuar në të, atëherë pala që do të tërhiqet është e detyruar të lajmërojë palën tjetër 1 muaj para përfundimit të njëanshëm të kontratës së qirasë.

Për zgjidhjen e çdo konflikti që mund të lind gjatë kësaj kohe dhe për të cilin palët nuk mund të merren vesh mes njëri tjetrit, ato mund ti drejtohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësorë në juridiksionin e së cilës ndodhet kjo pronë.

Bashkëlidhur, gjendet dokumentacioni i mëposhtëm: Kopje e mjeteve të identifikimit të palëve. Kopje e Certifikatës për Vërtetim Pronësie për pronën objekt kontrate

Kontrata e qirasë, u lexua nga unë noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të palëve kontraktuese, të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noterës. Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62, 63 e vijues të ligjit nr. 110/2018 "Për Noterinë", vërtetoj nënshkrimin e tyre. Në zbatim të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", unë Noter/ia deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

**QIRADHËNËS**

Hane Ferizolli

*Hane Ferizolli*

*Hf*

**QIRAMARRËS**

Bujar Ferizolli

*Bujar Ferizolli*

*Bf*

**NOTERË**

FLLADINA F. KASTRATI

*[Signature]*